



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 127

Tiranë – E mërkurë, 16 korrik 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 48/2025, datë 3.7.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 11.6.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’”, i ndryshuar..... 19007
Dekret i Presidentit nr. 247, datë 14.7.2025	Për shpallje ligji..... 19007
Ligj nr. 51/2025, datë 3.7.2025	Për rezervat materiale të shtetit..... 19007
Dekret i Presidentit nr. 246, datë 11.7.2025	Për shpallje ligji..... 19013
Dekret i Presidentit nr. 230, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 19013
Dekret i Presidentit nr. 251, datë 14.7.2025	Për lirim ambasadori nga detyra..... 19013
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22, datë 10.7.2013	Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” 19013
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 98, datë 9.7.2025	Për delegim kompetence..... 19018
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 9845, datë 14.7.2025	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe protokollit ndryshues..... 19018

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 130, datë 27.6.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025”...	19018
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 2241, datë 15.4.2025	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Vjona Fagu.....	19020
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Mirela Nasi.....	19020

**LIGJ**
Nr. 48/2025**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 6, DATË 11.6.2025, “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 115/2024, ‘PËR BUXHETIN
E VITIT 2025’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 11.6.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’”, i ndryshuar.

Miratuar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr. 247, datë 14.7.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 247, datë 14.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 48/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 11.6.2025, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 51/2025**PËR REZERVAT MATERIALE
TË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është vendosja e bazave juridike dhe administrative për rregullimin e përbërjes, planifikimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, mirorganizimin dhe miradministrimin e rezervave materiale të shtetit, në funksion të mbrojtjes së popullsisë, ekonomisë, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisit, si dhe dhënies së ndihmave humanitare.

Neni 3
Misioni

Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë, në situata të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, në rast të çrregullimit të tregut, të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, shëndetin e popullatës, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisin, si dhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.



Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrim” përfshin shpërndarjen, këmbimin, freskimin, plotësimin, ruajtjen ose mirëmbajtjen, heqjen, seleksionimin, huadhënien, blerjen, shitjen dhe çdo veprim tjetër që mund të kryhet me rezervat materiale të shtetit.

2. “Çrregullim i tregut” është prishja e theksuar e ekuilibrave të tregut, për shkak të rritjes së inflacionit, ku për përballimin e nevojave të tregut vendas, me vendim të Këshillit të Ministrave apo akt tjetër nënligjor, vendoset furnizimi apo plotësimi i nevojave me mall rezervë shteti.

3. “Dhurim” është dhurimi i rezervave materiale të shtetit vendeve të huaja në nevojë, brenda apo jashtë mekanizmit të mbrojtjes civile.

4. “Emergjencë civile” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.

5. “Fatkeqësi natyrore” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.

6. “Fatkeqësi të tjera” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për mbrojtjen civile.

7. “Freskim” është zëvendësimi i rezervës materiale të shtetit për produktet, që janë në limitet e kohëruajtjes ose kur ato paraqesin rrezik zhvlerësimi cilësor.

8. “Heqje” është veprimi administrativ, që kryhet kur prona nuk mund t’i shërbejë më qëllimit, sipas këtij ligji, dhe është e domosdoshme të veprohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

9. “Infrastrukturë magazinuese” përfshin ambientet për vendosjen dhe ruajtjen e rezervave materiale të shtetit.

10. “Këmbim” është zëvendësimi i vlerës së mallit me një vlerë malli të një lloji tjetër, në cilësinë e kërkuar dhe në sasinë përkatëse, në varësi të vlerës monetare.

11. “Limit maksimal i rezervës materiale të shtetit” janë sasi të artikullit, të shprehura në njësi matëse, të cilat vlerësohen si maksimale nga pikëpamja e nevojave në Republikën e Shqipërisë.

12. “Limit minimal i artikullit të rezervës materiale të shtetit” është sasia e caktuar, e shprehur në njësi matëse, nën të cilën nuk duhet të bjerë sasia e rezervës materiale të shtetit të këtij artikulli.

13. “Mallra ndihmë humanitare” përfshijnë të gjitha ato mallra, që i jepen shtetit shqiptar si ndihmë

humanitare nga shtete, donatorë dhe individë për rastet sipas parashikimeve në nenin 2 të këtij ligji.

14. “Mallra të konfiskuara” përfshijnë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet që kanë vlerë përdorimi për rezervën materiale të shtetit.

15. “Mallra rezervë” përfshijnë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale, që financohen nga buxheti i shtetit për të përballuar situatat e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji.

16. “Ministri” është ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit.

17. “Nomenklaturë” është tërësia e emërtimeve të mallrave ose sendeve rezervë materiale shteti.

18. “Operatorë ekonomikë” janë persona juridikë, fizikë, të cilët kanë ose krijojnë marrëdhënie kontraktore me rezervat materiale të shtetit për administrimin e mallrave rezervë të shtetit.

19. “Plotësim” është shtimi i sasisë së rezervës materiale të shtetit deri në limitet maksimale, të përcaktuara për to.

20. “Rezervë materiale e shtetit” përfshin tërësinë e mallrave rezervë dhe aseteve, që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

21. “Ruajtje apo mirëmbajtje” përfshin bashkësinë e të gjithë veprimtarisë së administratës së rezervës dhe të agjentëve ekonomikë gjatë fazave të trajtimit për rezervat materiale të shtetit.

22. “Seleksionim” është përzgjedhja e mallrave rezervë të shtetit dhe ndarja e tyre nisur nga vetitë, gjendja fizike dhe funksionaliteti.

23. “Strukturë e posaçme” është strukturë jo e përhershme, që krijohet për menaxhimin e situatave të gjendjes së luftës e të akteve të ndryshme terroriste, si dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

24. “Shpërndarje” është dhënia falas ose transferimi pa pagesë i rezervave materiale të shtetit.

25. “Zëvendësim” është zëvendësimi i vlerës së mallit me një vlerë të mallit të të njëjtit lloj, të barabartë në cilësi, përkatësisht në sasi.



KREU II
PËRBËRJA, PLANIFIKIMI DHE
ADMINISTRIMI I REZERVAVE MATERIALE
TË SHETËTIT

Neni 5
Përbërja

Rezervat materiale të shtetit përbëhen nga:

- a) mallrat rezervë, që financohen nga buxheti i shtetit;
- b) mallrat, që vijnë si ndihmë humanitare;
- c) mallrat, që kalojnë në pronësi të shtetit nga kundërvajtjet administrative dhe kryerja e veprave penale, të cilat kanë vlerë përdorimi për rezervën materiale të shtetit;
- ç) asetet që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë e që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 6
Planifikimi

1. Planifikimi i rezervave materiale të shtetit bëhet nëpërmjet Planit Strategjik Afatmesëm të Rezervave Materiale të Shtetit dhe programit vjetor të rezervave materiale të shtetit.

2. Plani Strategjik Afatmesëm i Rezervave Materiale të Shtetit është dokumenti bazë i planifikimit dhe i zhvillimit të rezervave materiale të shtetit.

3. Plani Strategjik Afatmesëm i Rezervave Materiale të Shtetit përmban:

- a) vendvendosjen;
- b) infrastrukturën magazinuese dhe sistemin e sigurisë;
- c) nomenklaturën e rezervave materiale të shtetit;
- ç) sasinë minimale të mallrave, sipas llojit, e cila duhet të jetë gjithnjë gjendje për nevoja të furnizimit në raste të situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste;
- d) sasinë maksimale të mallrave, sipas llojit, e cila vlerësohet si maksimale nga pikëpamja e nevojave në Republikën e Shqipërisë, në raste të situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste;
- dh) plotësimin e nomenklaturës së rezervave materiale të shtetit;

e) shpërndarjen territoriale të rezervave materiale të shtetit;

ë) burimin e mjeteve financiare dhe shpërndarjen e tyre sipas destinacionit;

f) koston për ruajtjen e mallit rezervë shteti nga operatorët ekonomikë;

g) plotësimin e infrastrukturës magazinuese dhe sigurisë;

gj) medikamentet dhe pajisjet mjekësore;

h) furnizimin;

i) zëvendësimin;

j) freskimin;

k) përdorimin;

l) shpërndarjen;

ll) mirëmbajtjen;

m) shitjen;

n) këmbimin;

nj) dhurimin.

4. Programi vjetor për rezervat materiale të shtetit është veprimtaria teknike e planifikuar dhe hartohet në përputhje me Planin Afatmesëm Strategjik, në të cilin përcaktohet mënyra e zbatimit të elementeve përbërëse të Planit Afatmesëm Strategjik për vitin përkatës.

5. Plani Strategjik Afatmesëm i Rezervave Materiale të Shtetit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rishikohet çdo 3 vjet.

6. Programi vjetor për rezervat materiale të shtetit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit.

7. Plani Strategjik Afatmesëm i Rezervave Materiale të Shtetit dhe programi vjetor për rezervat materiale trajtohen sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 7
Përdorimi

Rezervat materiale të shtetit përdoren për nevoja të furnizimit në raste:

a) të gjendjes së luftës dhe akteve terroriste;

b) të gjendjes së jashtëzakonshme;

c) të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si pasojë e këtyre të dyjave, si dhe të çrregullimit të tregut;

ç) të dhënies së ndihmave humanitare të shteteve tjera të dëmtuara, sipas normave të së drejtës ndërkombëtare ose akteve të tjera nënligjore.



Neni 8 Shpërndarja

1. Shpërndarja e mallrave rezervë materiale të shtetit bëhet në rastet:

a) e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 7 të këtij ligji, gjatë së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit zbaton vendimet e dhëna nga strukturat e posaçme për menaxhimin e situatës;

b) e përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 7 të këtij ligji, gjatë së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit zbaton vendimet e dhëna nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile;

c) e përcaktuara në shkronjën “ç” të nenit 7 të këtij ligji, gjatë së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi për ndihmat humanitare ose aktet e tjera nënligjore për këtë qëllim.

2. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit vlerëson dhe shpërndan mallra rezervë shteti, me kërkesë të kryetarit të bashkisë në situatat e emergjencave civile vendore dhe prefektit të qarkut në situatat e emergjencave civile rajonale, ku përcaktohet lloji i fatkeqësisë, përmbledhja e situatës emergjente aktuale, duke shprehur dhe pamundësinë e pushtetit lokal në mbështetjen e popullsisë, si dhe listën e nevojave për mbështetje.

3. Shpërndarja e mallrave rezervë materiale të shtetit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 9 Financimi

1. Fondet për krijimin, plotësimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Burimet e financimit të rezervave materiale të shtetit përbëhen nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) donacione të ndryshme;
- c) burime të tjera të ligjshme.

Neni 10 Shitja

1. Mallrat rezervë shteti shiten në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankandin publik, në rast të:

- a) pamundësisë së freskimit të tyre me institucionet publike apo me operatorët ekonomikë;
- b) tejkalimit të gjendjes maksimale dhe pamundësisë së freskimit të tyre.

2. Të ardhurat që krijohen nga shitja e mallrave rezervë mbeten në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me destinacion përdorimi për plotësimin e sasive të artikujve të shitur.

Neni 11 Ruajtja e limitit minimal

1. Kur nuk vendoset ndryshe, shpërndarja, freskimi, këmbimi, zëvendësimi ose shitja e mallrave rezervë bëhen duke ruajtur limitin minimal të tyre.

2. Për mallrat ndihmë humanitare nuk përcaktohet limiti minimal. Ato administrohen dhe përdoren si mallrat rezervë.

Neni 12 Marrja në dorëzim

1. Mënyra e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit rregullohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

2. Rezerva materiale e shtetit nuk merr në dorëzim mallra:

- a) të skaduara apo me afat përdorimi jo më pak se 6 muaj para afatit të skadimit;
- b) pa vlerë përdorimi për rezervën materiale të shtetit.

Neni 13 Blerja e rezervave materiale të shtetit

Blerja e rezervave materiale të shtetit, sipas planifikimeve buxhetore të bëra në programin vjetor, siguron plotësimin e nevojave të rezervës materiale të shtetit për:

- a) infrastrukturën magazinuese dhe sigurisë;
- b) mjetet logjistike dhe karburantet;
- c) mallrat ushqimore rezervë shteti;
- ç) mallrat industriale rezervë shteti.



Neni 14

Freskimi i mallrave rezervë

1. Freskimi i mallrave rezervë bëhet nëpërmjet këmbimit apo zëvendësimit me institucione që financohen nga buxheti i shtetit apo operatorët ekonomikë, që kanë kontrata të ngjashme furnizimi për këto mallra.

2. Kur freskimi nëpërmjet këmbimit apo zëvendësimit nuk realizohet me institucione që financohen nga buxheti i shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit siguron freskimin e mallrave rezervë me operatorët ekonomikë, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, duke ruajtur cilësinë e mallrave.

Neni 15

Seleksionimi

Seleksionimi i artikullit rezervë materiale të shtetit bëhet vetëm në rastet e avarisë së pakthyeshme ekologjike, të shkaktuara nga forcat madhore, të rrezikimit të jetës apo të shëndetit, si dhe për mbrojtjen nga zhvlerësimi i menjëhershëm i sasive të rezervës materiale të shtetit. Seleksionimi mund të bëhet edhe për materialet e përdorura apo të dëmtuara në situatat e parashikuara në nenin 3, të këtij ligji.

Neni 16

Magazinimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e mallrave

1. Magazinimi afatgjatë i produkteve kryhet në njësitë rajonale vartëse.

2. Për mallrat e rezervave materiale të shtetit, në rast pamundësie magazinimi në njësitë rajonale vartëse apo nevojë për mirëmbajtje të mallrave, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit lidh kontrata për ofrimin e shërbimit të magazinimit me operatorët ekonomikë, të cilët plotësojnë kushtet teknike të nevojshme dhe të domosdoshme për të siguruar pandryshueshmërinë e gjendjes cilësore të mallrave rezervë materiale të shtetit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

KREU III

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHETIT

Neni 17

Organizimi dhe funksionimi

1. Rezervat materiale të shtetit administrohen nga ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (në vijim “DPRMSH”), në mënyrat dhe kushtet që përcaktohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit, me seli në Tiranë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit organizohet në dy nivele, qendror dhe rajonal.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit ushtron këto përgjegjësi funksionale:

a) zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e rezervave materiale të shtetit;

b) zbaton drejtimit strategjike dhe objektivat e përcaktuar nga ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit;

c) bashkëpunon me organizatat homologe ndërkombëtare dhe organizmat ndërkombëtarë, në kuadër të zgjidhjes efektive të problemeve në fushën e rezervave materiale të shtetit, si dhe veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe në normat e së drejtës ndërkombëtare;

ç) lidh marrëveshje me organizatat homologe ndërkombëtare dhe organizmat ndërkombëtarë për rezervat materiale të shtetit.

5. Organizimi dhe funksionimi i DPRMSH-së, si dhe detyrat e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

6. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit përgjigjet për drejtimin dhe



kontrollin e veprimtarisë administrative të degëve të saj rajonale.

8. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në nivel qendror dhe rajonal, gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

9. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të DPRMSH-së, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

10. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të DPRMSH-së, në nivel qendror dhe rajonal, miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Neni 18

Drejtori i përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit është autoriteti më i lartë administrativ i DPRMSH-së dhe përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për realizimin e politikave dhe të objektivave të përcaktuar.

2. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit është nëpunës civil, i cili emërohet dhe lirohet nga detyra sipas legjislacionit për shërbimin civil.

3. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit ka këto detyra:

a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit;

b) përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit;

c) emëron dhe liron nga detyra punonjësit administrativë të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe të degëve rajonale në varësi të saj;

ç) menaxhon dhe është përgjegjës për buxhetin;

d) nxjerr urdhra e udhëzime për veprimtarinë e strukturave të saj, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e rezervave materiale të shtetit;

dh) bashkërendon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e rezervave materiale të shtetit;

e) siguron vendvendosjen e rezervave materiale të shtetit;

ë) siguron krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit në përputhje me qëllimin dhe kërkesat e këtij ligji;

f) kryen detyra të tjera në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

4. Drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit informon periodikisht ministrin përgjegjës për rezervat materiale të shtetit, Këshillin e Ministrave dhe, kur i kërkohet, Komitetin Ndërminstor të Emergjencave Civile për gjendjen e mallrave rezervë materiale të shtetit.

Neni 19

Bashkëpunimi

Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit bashkëpunon me ministrinë, institucionet qendrore, personat fizikë dhe juridikë, në funksion të ushtrimit të detyrave e të funksioneve të saj.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 6, të pikës 1 të nenit 12 dhe të pikës 5 të nenit 17 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 6 të nenit 17 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 6, të nenit 6, dhe të pikës 10 të nenit 17 të këtij ligji.

4. Aktet nënligjore, të nxjerra deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 21

Shfuqizime

Ligji nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.



Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr. 246, datë 11.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 246, datë 11.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 51/2025, “Për rezervat materiale të shtetit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 230, datë 10.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Gerda Roland Mandler (Llazari)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 251, datë 14.7.2025

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Besiana Kadare lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO), rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM
Nr. 22, datë 10.7.2013

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 870,
DATË 14.12.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN
FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË
DËRGOHEN ME SHËRBYM JASHTË
VENDIT”**

Në zbatim të vendimit nr. 870, datë 14.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të



punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 15 e tij, ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët për përmbushjen e detyrave funksionale të institucionit që përfaqësojnë, duhet të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, si konferenca, delegacione, marrëveshje, bisedime dhe protokolle, takime pune etj., të cilat organizohen jashtë vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit të tyre. Punonjës të njësive të qeverisjes së përgjithshme në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohen punonjësit organikë të njësive. Në rastet kur përfaqësimi në aktivitetet ndërkombëtare realizohet me pjesëmarrjen e punonjësve nga njësi të ndryshme të qeverisjes së përgjithshme, shpenzimet e tyre, si rregull, përballohen nga buxheti i çdo njësie përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Për entet publike jobuxhetore dhe ndërmarrjet shtetërore/shoqëritë tregtare me kapital mbi 50 për qind shtetëror, në rastet kur përfaqësimi në aktivitetet ndërkombëtare realizohet me pjesëmarrjen edhe të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme, përballimi i shpenzimeve të tyre mund të kryhet nga buxheti i këtyre enteve.

2. E drejta për të përcaktuar nivelin e përfaqësimit të institucionit (nivel drejtues i lartë, i mesëm ose nivel specialisti) në këto aktivitete jashtë vendit, si dhe numrin e nëpunësve/ punonjësve pjesëmarrës, është e titullarit të institucionit qendror nga i cili varet njësia shpenzuese.

Në rastin kur titullari i institucionit qendror, e gjykon të arsyeshme delegimin e kësaj kompetence te një funksionar tjetër, i deleguari i tij duhet të jetë një nëpunës i nivelit pasardhës në hierarkinë e institucionit. Në çdo rast (pra edhe në rastet kur titullari i institucionit qendror e delegon këtë kompetencë), miratimi i programit paraprak vjetor të shërbimeve jashtë vendit kryhet nga titullari në fillim të çdo viti, në përputhje me fondet buxhetore të miratuara për këtë qëllim. Edhe në rastet kur gjatë zbatimit të tij ky program ndryshon, miratimi i ndryshimeve kryhet vetëm nga titullari.

Bazuar në këtë program vjetor, përgatitet autorizimi për dërgimin e punonjësve me shërbim jashtë vendit sipas formatit nr. 1, bashkëlidhur dhe

pjesë e këtij udhëzimi. Në miratimin e autorizimit duhet të merret në konsideratë jo vetëm rëndësia e aktivitetit, por gjithashtu në frymën e përdorimit me efektivitet dhe eficiencë të burimeve financiare publike duhet të mirargumentohet lidhja e aktivitetit me pozicionin e punës dhe sidomos me numrin e punonjësve që do të dërgohen me shërbim jashtë vendit. Një kopje e aplikimit për pjesëmarrjen në aktivitetet jashtë vendit, së bashku me argumentimin e sipërcituar dhe eventualisht certifikatën/diplomën përkatëse që merret në përfundim të aktivitetit (kur jepet një dokument i tillë), duhet të dorëzohet pranë njësive të burimeve njerëzore të institucionit dhe/ose pranë njësive përgjegjëse për financat.

3. Për entet publike jobuxhetore dhe ndërmarrjet shtetërore/shoqëritë tregtare me kapital mbi 50 për qind shtetëror, titullar urdhërues, në kuptim të këtij udhëzimi është administratori/ drejtuesi, i cili raporton në institucionin e tij drejtues periodikisht për këto shpenzime, si pjesë e raportimit periodik të treguesve ekonomiko-financiar të entitetit.

4. Trajtimi financiar për realizimin e aktiviteteve jashtë vendit, përfshin të gjitha shpenzimet e përcaktuara në pikën 4 të vendimit, ose një pjesë të tyre, në varësi të faktit se kush e financon aktivitetin dhe mbulohen nga buxheti i njësive përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Në rastet kur këto shpenzime janë:

a) plotësisht në ngarkim të palës pritëse, punonjësit nuk trajtohen financiarisht nga buxheti i institucionit të tyre dhe nuk i detyrohen për asgjë këtij institucioni;

b) pjesërisht në ngarkim të palës pritëse, të cilat dokumentohen zyrtarisht nga pritësi, buxheti i institucionit përkatës përballon pjesën tjetër të shpenzimeve. Në të gjitha rastet, nëse pritësi merr përsipër përballimin e shpenzimeve të ushqimit (në të holla ose jo) dhe pavarësisht nga vlera këtij shpenzimi, punonjësi nuk trajtohet me dietë.

Njësia përgjegjëse për financën duhet të kërkojë dokumentimin e plotë të shpenzimeve që përballohen nga pritësi dhe është përgjegjëse për financimin e pjesës së mbetur të shpenzimeve.

5. Çdo punonjës, i cili dërgohet me shërbim jashtë vendit, bazuar në shkresën autorizuese të titullarit, kur shërbimi financohet tërësisht nga buxheti i institucionit, ka të drejtë të marrë në formë paradhënie likuiditeti (*cash-i*) atë pjesë të shpenzimeve që nuk lëvrohet nëpërmjet llogarisë së institucionit. Pra, si rregull, punonjësi merr në formë



paradhënie nga institucioni në momentin e nisjes vetëm shpenzimet e dietave ditore dhe ose pagesa e hotelit. Të gjitha shpenzimet e tjera të përcaktuara sipas pikës 4 të vendimit, ai mund t'i marrë në formë likuiditeti në momentin e nisjes, vetëm kur nuk është e mundur transferimi nëpërmjet llogarisë bankare nga institucioni te përfituesi.

Në përfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon të firmosur pranë zyrës së financës së njësisë, urdhërsërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qendror, ose të deleguarit të tij dhe të gjitha dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit. Urdhërsërbimi paraqitet sipas formatit nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Në përputhje me përcaktimet e pikave 8 dhe 9 të vendimit të sipërcituar, punonjësit që dërgohen jashtë vendit dhe kanë kryer shpenzime transporti dhe akomodimi, paguhen nga buxheti vetëm kundrejt dokumenteve përkatëse, sikurse janë biletat e transportit dhe faturat e hotelit. Në kuptim të këtij udhëzimi, në rastet kur udhëtimi kryhet me avion, si biletë transporti *njihet edhe boarding pass-i*. Në çdo rast, shpenzimet telefonike dhe shpenzimet e transportit urban nuk mbulohen nga buxheti i shtetit.

6. Kohëzgjatja e shërbimit jashtë vendit matet me ditë kalendarike dhe jo ditë pune dhe është tepër e rëndësishme në përlogaritjen e kostos së shërbimit. Për këtë arsye, titullari i institucionit qendror ose i deleguari i tij, në frymën e përdorimit me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, duhet të gjykojnë mbi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit apo në vetëm një kohë të kufizuar të tij. Për efekt të llogaritjes së dietës ditore të punonjësit që dërgohet me shërbim jashtë vendit, në përlogaritjen e ditëve të shërbimit mbahen në konsideratë rastet e mëposhtme:

- kur nisja dhe kthimi nga shërbimi jashtë vendit bëhet brenda një dite kalendarike, punonjësi përfiton një dietë ditore të plotë. Në këto raste, mund të ndodhë që pavarësisht se nuk do të flihet në hotel, për arsye të akomodimit të pjesshëm të punonjësve, mund të rezervohet një dhomë hoteli me të drejtë pagese, për të gjithë punonjësit;

- kur dërgimi i punonjësit me shërbim jashtë vendit në një ditë të caktuar kalendarike, bëhet para orës 8.00, dita e nisjes konsiderohet e plotë, ndërsa kur nisja bëhet pas orës 08:00, dita e nisjes konsiderohet gjysmë dite (1/2 ditë);

- kur kthimi nga shërbimi jashtë vendit në një ditë të caktuar kalendarike, bëhet pas orës 20.00, dita e kthimit konsiderohet e plotë, ndërsa kur kthimi bëhet para orës 20:00, dita e kthimit konsiderohet gjysmë dite (1/2 ditë).

7. Në raste tepër specifike, mund të ndodhë që për arsye madhore dhe të paparashikuara, punonjësi i caktuar për kryerjen e shërbimit jashtë vendit të mos niset me shërbim ose të kthehet pa e përfunduar atë. Në këto raste, të gjitha shpenzimet e kryera deri në atë moment së bashku me penalitetet përkatëse, nëse do të ketë të tilla, përballohen nga institucioni. Për efekt të këtij udhëzimi, si arsye madhore dhe të paparashikuara do të konsiderohen raste të tilla si: sëmundje e menjëhershme ose ndërrim jete e punonjësit, një anëtar i familjes së tij, fatkeqësi natyrore, anulime dhe vonesa të mjeteve të transportit që nuk varen nga punonjësi, të vërtetuara sipas dokumentit përkatës, urdhër i titullarit për angazhim në çështje të tjera që e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen në aktivitet, si dhe rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit. Në çdo rast tjetër të ndryshëm nga sa është specifikuar më sipër, shpenzimet përballohen nga vetë punonjësi.

8. Trajtime afatshkurtra, në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohen ato trajtime të cilat zgjasin jo më shumë se një muaj. Të gjitha llojet e trajtimeve të tjera jashtë vendit nuk mund të financohen nëpërmjet përcaktimeve të këtij vendimi, pra me dieta. Në rastet kur trajnimet financohen plotësisht apo pjesërisht nga pritësi do ndiqet e njëjta procedurë si në pikën 4 të këtij udhëzimi.

9. Shpenzimet për pagesa të tjera përfshijnë pagesa që lidhen me realizimin e shërbimit për të cilin punonjësi dërgohet jashtë vendit, si: siguracion shëndetësor, pagesë për marrjen e vizës dhe çdo taksë e detyrueshme, sipas legjislacionit të vendit pritës. Telefonatat nga hoteli apo telefoni celular personal, vizitat në objekte të ndryshme kulturore etj., nuk mbulohen nga shpenzimet e institucionit, por nga vetë punonjësi.

Në shpenzimet për pagesa të tjera është edhe tarifa e pjesëmarrjes (*fee-ja*) që paguhet në raste të veçanta në konferenca apo trajtime të caktuara. Në të gjitha këto raste, përpara konfirmimit të pjesëmarrjes, paraprakisht duhet të merret miratimi i titullarit të institucionit qendror nga varet njësia e qeverisjes së përgjithshme, pasi të jetë gjykuar mbi rëndësinë e aktivitetit dhe përfitimet që institucioni do të ketë nga kjo pjesëmarrje.



Për çdo shpenzim për pagesa të tjera, i paparashikuar në këtë udhëzim, merret miratimi i ministrit të Financave.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I FINANCEVE
Nezir Haldeda

FORMATI NR.1



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E _____

Nr. _____ Protokolli

Data ____/____/2013

AUTORIZIM PER SHERBIMIN JASHTË VENDIT

Ne zbatim të VKM nr. nr.870, datë 14.02.2011 të Keshillit të Ministrave, "Per trajtimin financiar te punonjesve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", dhe Udhëzimit nr. _____, datë ____/____/2013 të Ministrit të Financave, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Keshillit të Ministrave "Per trajtimin financiar te punonjesve që dërgohen me shërbim jashtë vendit",

AUTORIZOJ

Z/Znj. _____, specialist/drejtor/titullar i drejtorise/institucionit _____, te perfaqesoje Ministrine/institucionin ne _____ ose te marre pjese si perfaqesues ne aktivitetin/konferencen/takimin/trajnimin _____, me teme _____ qe do te organizohet ne shtetin _____, per nje periudhe prej _____ dite. Ministria/institucioni merr persiper pagesen e plote/ose pjesore per mbulimin e shpenzimeve te udhetimit/akomodimit/dietave/etj¹.

Bashkelidhur argumentimi i rendesise se pjesemarrjes se punonjesit/punonjesve ne aktivitetin/konferencen /takimin/trajnimin _____, e sipercituar.

TITULLARI I DELEGUARI I TIJ

Shenim: Ne autorizim te shenohen vetem ato shpenzime qe do te perballohen nga buxheti. Ne permbajtjen e autorizimit mund te shtohet edhe ftesa e ardhur per pjesmarrjen ne aktivitetin/konferencen/takimin/trajnimin si dhe cdo informacion tjeter qe gjykohet i nevojshem nga institucioni.

Alc
[Signature]





FORMATI NR.2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E _____
DREJTORIA E _____

Nr. _____ Protokolli

Data ____/____/2013

URDHER – SHERBIMI – PER JAShte VENDIT

Ne zbatim te VKM nr. nr.870, date 14.02.2011 te Keshillit te Ministrave, "Per trajtimin financiar te punonjesve qe dërgohen me shërbim jashtë vendit", dhe Udhëzimit nr. _____, date ____/____/2013 te Ministrit te Financave, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 te Keshillit te Ministrave "Per trajtimin financiar te punonjesve qe dërgohen me shërbim jashtë vendit", si dhe, mbështetur ne autorizimin nr. _____ Date, _____ Z/Znj. _____, specialist/drejtor/titullar i drejtorise/institucionit _____, do te perfaqesojë Ministrine/institucionin _____ (ose) do te marre pjese si perfaqesues ne aktivitetin/konferencen/takimin _____, me teme _____ qe do te organizohet ne shtetin _____ per ____ dite.

Kohezgjitja dhe destinacioni i udhetimit, i detajuar eshte:

Nisja nga _____ me date _____, dhe mberritja ne _____, date _____, Nenshkrimi _____.
Nisja nga _____ me date _____, dhe mberritja ne _____, date _____, Nenshkrimi _____.
Nisja nga _____ me date _____, dhe mberritja ne _____, date _____, Nenshkrimi _____.

Llogaritja e shpenzimeve te Udhëtimit, e detajuar eshte:

	Vlera ne EURO	Vlera ne USD
Shpenzime Hoteli =(nr.neteve) _____ x (cmimi nate) _____	= XXXX	
Shpenzime Udhëtimi bilete avion shoqeruar boarding pass	= XXXX	
Shpenzime Udhëtimi bilete taksi, tren etj	= XXXX	
Shpenzime Dieta = (nr.dite) _____ x (vlera/dite) _____	= XXXX	
Shpenzime te tjera (telefon, faks etj)	= XXXX	

I - Gjithsej Shpenzime

II – Paradhenie

Per te kthyer kur I – II = (-)

Per te marre kur I – II = (+)

Punonjesi udhetues

Nepunesi urdherues

Nepunesi zbatues

Shenim: Nepunes urdherues eshte nepunesi i cili ka ne varesi punonjesin udhetues.

Nepunes zbatues eshte vetem nepunesi i emeruar si nepunes zbatues i njesise.



**URDHËR**

Nr. 98, datë 9.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ndarjes V, të nënndarjes “I”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, z. Kastriot Gurra, për të autorizuar dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me largësi mbi 100 km.

2. Në bazë të pikës 1 të këtij urdhri, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, në çdo autorizim përcakton kohën e zgjatjes së shërbimit, qëllimin e tij dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

4. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e ASHSH-së për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

NJOFTIM

Nr. 9845, datë 14.7.2025

**PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE
DHE PROTOKOLLIT NDRYSHUES**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”, nënshkruar në Tiranë, më 14.1.2009, hyrë në fuqi më 25.6.2025.

“Protokolli ndryshues i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”, nënshkruar në Luksemburg, më 21.10.2020, hyrë në fuqi më 25.6.2025.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi**

VENDIM

Nr. 130, datë 27.6.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 112, DATË
23.5.2025, “MBI LLOGARITJEN E
PAGESAVE RREGULLATORE PËR
VITIN 2025”**

Në mbështetje të neneve 17, pika 4 dhe 20, germa “d”, 45 dhe 46, 51, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 14 dhe 30, pika 3, nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 6, pika 6.3, të “Rregullores mbi përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e



Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, me nr. 1750/1 prot., datë 25.6.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, ‘Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 112, datë 23.5.2025, ka miratuar përlllogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025, për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Pas miratimit të këtij vendimi, në procesin e rishikimit të të dhënave të licencimit dhe të aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit 2024 nga subjektet e licencuara, u konstatua se subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., edhe pse zotëron licencë aktive në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nuk është përfshirë në listën e përlllogaritjes së pagesave rregullatore për vitin 2025.

- Nga të dhënat e raportuara dhe verifikuara nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, rezulton se gjatë vitit 2024 ky subjekt nuk ka ushtruar aktivitet tregtar në veprimtarinë e licencuar. Në përputhje me nenin 6, pika 6.3, të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, për subjektet që nuk kanë realizuar aktivitet gjatë vitit ushtrimor, aplikohet një pagesë rregullatore fikse në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë.

- Përfshirja e subjektit “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. në përlllogaritjen e pagesave rregullatore, për vitin 2025, kërkon ndërhyrje në tabelën nr. IV, të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, si dhe sjell domosdoshmërinë e ndryshimit të përmbajtjes së pikës 2 të po këtij vendimi, vetëm për qëllime të trajtimit të diferencave që rrjedhin nga ky përditësim.

- Pagesa rregullatore për vitin 2025, për subjektin “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të kryhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Në të kundërt, ERE, në zbatim të nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, do të aplikojë ndaj të licencuarit masat administrative përkatëse, përfshirë gjobën deri në 3% të të ardhurave të vitit paraardhës dhe kamatëvonesën në

masën 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesë.

- Mbështetur në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi publik që e ka nxjerrë, vlerësohet e nevojshme ndërhyrja në vendimin nr. 112, datë 23.5.2025, për të reflektuar shtimin e subjektit “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në tabelën nr. IV të atij vendimi dhe për të përshtatur përmbajtjen e pikës 2 të dispozitivit, me qëllim përfshirjen e diferencave që rrjedhin nga ky përditësim në përlllogaritjen e pagesave të periudhës pasardhëse.

- Si rrjedhojë, pika 2, e vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, vlerësohet të riformulohet si më poshtë: “Diferencat në vlerë që do të rezultojnë nga përlllogaritja e pagesës rregullatore sipas këtij vendimi, për të gjitha shoqëritë e licencuara të cilat janë subjekt të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, “Mbi përlllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025” (sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi), do të korrigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse”.

- Ndryshimet e parashikuara në këtë vendim kufizohen vetëm në përfshirjen e subjektit “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në tabelën IV, të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, si dhe në ndryshimin përkatës të pikës 2 të po këtij vendimi. Dispozitat e tjera të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, mbeten në fuqi dhe zbatohen pa ndryshime për të gjitha subjektet e tjera të licencuara të përfshira në atë vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në tabelën IV, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, shtohet subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me NIPT L41811003F, me pagesë rregullatore për vitin 2025 në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, ndryshon dhe bëhet: “Diferencat në vlerë që do të rezultojnë nga përlllogaritja e pagesës rregullatore sipas këtij vendimi, për të gjitha shoqëritë e licencuara të cilat janë subjekt të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, “Mbi përlllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025” (sipas tabelës



bashkëlidhur këtij vendimi), do të korrigojen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM *(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 2241, datë 15.4.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Vjona Fagu, e datëlindjes 31.1.1985 dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e kërkueses Anisa Fagu.

KËRKESË

Shtetasja Zioca Zisi kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, shpalljen të vdekur të shtetasës Mirela Nasi, me atësi Gogo dhe amësi Agathi, e datëlindjes 12.8.1975.

KËRKUESE
Zoica Zisi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 80 lekë